



Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-512223 Mail: [mjekesia@uni-pr.edu](mailto:mjekesia@uni-pr.edu)

UNIVERSITETI I PRISHTINES "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I MJEKËSISË  
PRISHTINE

Pranuar më:	14.09.2022		
Nr. 099	099	099	Vlera
	89/12		

Ref. nr.

Prishtinë,

/09/2022

## NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatet të cilët janë të interesuar për Transfer nga Universitetet Tjera në Universitetin e Prishtinës – Fakultetin e Mjekësisë, se afati për aplikim, transfer është prej datës 15.09.2022 deri me datën 23.09.2022. Kandidatet mund të paraqesin kërkesë me shkrimë për lejimin e transferit duke iu referuar Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kërkesat për transfer, mund t'i paraqesin në Dekanatin e Fakultetit të Mjekësisë – Arkiv.

### Ndërrimi i drejtimit të studimeve

#### Neni 142

- (1) Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.
- (2) Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti;
- (3) Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
- (4) Sipas pikës (3), studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:

1. Më së paku në vitin e tret të studimeve për Fakultetin e Mjekësisë; Vendimi i Senatit të UP-së për vitin akademik 2021/2022.

2. Më së mirë në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.

- (5) Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studentit duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve në pajtim me pikën (3). dhe (4).

### Neni 143

- (1) Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të njësisë akademike ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të jetë evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
- (2) Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.
- (3) Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e komisionit të studimeve.
- (4) Ankesa kundër kërkesës së refuzuar për ndërrimin e programit të studimit duhet t'i bëhet këshillit të njësisë akademike nga studenti brenda 8 ditëve të punës pas publikimit të vendimit.

### Neni 144

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin e Prishtinës do të vlejné rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit.

- *Të drejtën e transferim ta ketë: studentilja i /e cili /a i ka të plotësuar kriteret e njëjta me studentet e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (UP-FM).*
- *Numri i studenteve të transferuar të jetë 5% i numrit të studenteve të rregullt të vitit të tretë, përkatësisht të vitit të katërt, përkatësisht të vitit të pestë.*
- *Përqindja e studenteve të llogaritet në raport me vitin paraprak.*
- *Në rastet kur më shumë kandidatë përmbushin kushtet e lartcekura të transferit, atëherë përparësi të ketë nota mesatare.*
- *Në rastet kur me shumë kandidat përmbushin kushtet e lartcekura të transferit dhe kanë notë mesatare të njëjtë, atëherë përparësi t'i ipet studentit me numër më të madh të provimeve të kaluara.*

#### **Kandidatët duhet të paraqesin:**

- *Indeksin*
- *Certifikata e notave*
- *Vërtetimin student i rregullt*
- *Planprogramin e studimeve*

Kërkesat për transfer, mund t'i paraqesin në Dekanatin e Fakultetit të Mjekësisë - Arkiv- **prej datës 15.09.2022 deri me datën 23.09.2022.**

**Nga Komisioni:**

